



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Mars, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit mars të vitit 2020, përkundër sfidave dhe vështirësive të mëdha që ka paraqitë përhapja e pandemisë COVID-19, ka arritur me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë t'i realizojë punët dhe detyrat e shumta të parapara sipas planit të veprimit, dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura si rrjedhojë e situatës së potencuar.

Drejtoria e Arsimit në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia, kanë arritur të sigurojnë mësim nga distanca për nxënësit tanë, duke mos i shkëputur nga procesi edukativo-arsimor.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;

- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës, në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performances;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartimi i politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Hartimi i Planit për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ;
- Zbatimi i Planit për zhvillimin profesional;
- Organizimi i garës "Shkencëtari i ri"
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese gjatë vitit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;

- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti etj. në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – ne te të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë);
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonimë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë, për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimin nëpër shkollë;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;

- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin DDD-ja e institucioneve edukativo-arsimore;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin “Furnizimi me material pedagogjik i institucioneve arsimore”;
- Përgatitja e lëndëve të mbetura për pagesë;
- Furnizimi me inventar i disa shkollave;
- Furnizimi me lëndë djegëse i shkollës “ Qamil Batalli”, shkollë ku mbahet mësimi online;
- Përcjellja dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim, dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, këshilluese, speciale dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin edukativo-arsimor të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit mars të vitit 2020, kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 8 vizita kontrolluese në IEAA, lidhur me informimin rreth mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor, mbajtjes së pastërtisë dhe pajisja e shkollës me mjete higjienike, deri më 11 mars, si në: SHFMU “Elena Gjika”, SHFMU “Gjergj Fishta”, SHFMU “Nëna Terezë”, SHFMU “Nexhmi Mustafa”, SHFMU “Naim Frashëri”, SHFMU “Iliria”, SHML “7 Shtatori” dhe SHML “Gjin Gazulli”, ndërsa 7 vizita informuese dhe 3 vizita speciale në SHFMU “Dardania”, SHML “Abdyl Frashëri dhe IP “Ardhmënia”.

- **Mësimi në distancë**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në koordinim dhe

në mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës dhe mekanizma të tjerë në këto rrethana të jashtëzakonshme për vendin tonë, kanë filluar me zhvillimin e projektit për organizimin dhe mbajtjen e mësim



në distancë-online, për nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar (I-IX), në mënyrë që nxënësve të këtij nivelit të arsimit t'ju sigurohet mësimdhënie në këto rrethana, duke mos u shkëputur nga procesi arsimor pavarësisht situatës së krijuar.

Andaj, në këtë proces të rëndësishëm dhe në këto rrethana të jashtëzakonshme që po kalon vendi i ynë dhe e tërë bota, si pasojë e Koronavirusit COVID-19, falënderojmë të gjitha ata që janë duke kontribuar në këtë proces të



mësimdhënies dhe, në veçanti për rreth 100 mësimdhënës tanë, të cilët kanë shprehur gatishmëri të lartë për mbështetjen në jetësimin e këtij projektit dhe ofrimin e mësimit për nxënësit tanë nga distanca, derisa të kalohet kjo gjendje emergjente. Njëherësh do të shkohet në transmetim vetëm me lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë, për të vazhduar nga muaji prill me shumicën e lëndëve;

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të krijimit të një platformës virtuale për mësimin në distancë, ka realizuar takim me kompani për të diskutuar mundësitë e mbështetjes për nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, në mënyrë që të vendoset një platformë e standardizuar, e cila do të lehtësonte komunikimi dhe koordinimin e mësimin nga distanca.



Është e rëndësishme që gjatë kësaj kohe të jashtëzakonshme që po kalon vendi ynë dhe e tërë bota, si pasoj e pandemisë COVID-19, nxënësve tanë t'u ofrojmë mësimdhënie kualitative nga distanca, duke u përshtatur me situatën dhe rrethanat nëpër të cilën po kalojmë, sepse kjo ka ndikim pozitiv në mirëqenien e tyre.



- Gjatë muajit mars 2020, Drejtoria e Arsimit në koordinim me Zyrën e Bashkimit Evropian, kanë organizuar trajnimin për zhvillimin profesional të 220 mësimdhënësve, të nivelit fillor dhe parafillor të shkollave fillore: "Ismail Qemali", "Hasan Prishtina", "Meto Bajraktari", "Zenel Hajdini", Hilmi Rakovica", "Naim Fashëri" dhe "Afrim Gashi";
- Drejtoria e Arsimit, për t'u siguruar se procesi i zhvillimit profesional i mësimdhënësve realizohet në nivelin e standardeve të kërkuara, vazhdimisht trajnimet monitorohen nga zyrtarët e arsimit;
- Drejtoria e Arsimit, vazhdimisht përcjellë dhe u përgjigjet profesionalisht kërkesave dhe nevojave të mësimdhënësve për ngritjen dhe zhvillim profesional të tyre në segmente të caktuar;

- Në funksion të implementimit dhe zbatimit të kurrikulës së re sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara, Drejtoria e Arsimit në koordinim me ekipin profesional në nivel komune, janë duke u përgjigjur në mënyrë profesionale zhvillimeve reformuese, duke organizuar edhe punëtori, me qëllim zgjidhjen dhe tejkalimin e sfidave të paraqitura;
- Në bazë të mbështetjes profesionale dhe të vazhdueshme që është duke u ofruar mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave nga ekipi profesional, implementimi i KK-së në shkolla tona është duke u monitorua dhe zbatuar relativisht mirë, pavarësisht sfidave;
- Sipas nevojës dhe kërkesës së mësimdhënësve, realizohen takime bashkëpunues në mes mësimdhënësve të shkollave të ndryshme të drejtuar nga trajner të KK-së, për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave;
- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentorua nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitur formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj. Në këtë muaj edhe përkundër sfidës që ka paraqitur pandemia, konsultimet në mes aktiveve kanë qenë permanente përmes platformave digjitale;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimin joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, Ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Ekipi vlerësues për nxënës me nevoja të veçanta i Komunës së Prishtinës, në muajin mars 2020, ka bërë vlerësimin e dy nxënësve. Të dy nxënësit janë referuar në shkollë të rregullt dhe raportet e vlerësimit i janë dërguar shkollës. Pasi që shkollat janë mbyllur nga data 11 mars, për shkak të rrezikut nga pandemia Covid-19, Ekipi nuk ka pasur mundësi të bëjë vlerësime të tjera në këtë muaj.
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale, gjatë muajit mars është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm, kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit dhe nga gjysma e muajit mars përhapja e pandemisë COVID-19 etj. Pra, është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale;

- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komfor legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Komuna e Prishtinës ka marrë pjesë në konferencën *“Fuqizimi i gruas në institucione dhe roli i saj në zhvillimin e shtetit”* . Kjo konferencë ka për qëllim shënimin e ditës ndërkombëtare të gruas - 8 Marsi dhe sensibilizimit dhe fuqizimit të gruas në institucione, me fokus në institucionet e sigurisë dhe në vendimmarrje;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes, e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Takime me prindër të shkollave të ndryshme;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit mars;
- Pajisja e institucioneve edukativo-arsimore me kutia të ndihmës së parë, për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kiflet, deri më 11 mars, kur u ndërpre procesi arsimor si pasojë e pandemisë COVID-19;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Janë përcjellë të gjitha projektet të Zyra e prokurimit, për të vazhduar me procedura të tjera;
- Është furnizuar me lëndë djegëse shkolla fillore “Qamil Batalli”;
- Janë furnizuar me inventar disa shkolla;
- Janë furnizuar institucionet edukativo-arsimore me lëndë djegëse për ngrohje;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Organizimi i garës "Shkencëtari i ri";

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, mars-2020

Buxheti i shpenzuar dhe alokuar marsi-2020				
	Alokim	Shpenzim	Zotim -Oblig.	Mbetje -S=
Paga	1,559,806.68	1,559,806.68	-	-
Komunali	339,321.05		4,842.32	334,478.73
10-MSH	754,545.49	603,341.25	39,386.12	111,818.12
21-MSH	63,591.03	60,653.73	-	2,937.30
Subvencione	48,540.00	28,790.00		19,750.00
Donacione	-	-	-	-
HUAJA-Grant i BB	-	-		
FB-10-Kapitale	-	-	-	-
FB-21-Kapitale	354,695.79	36,085.57	-	318,610.22
Totali:	3,120,500.04	2,288,677.23	44,228.44	787,594.37

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit mars ka realizuar mbi 47 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit mars të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- ministren e Arsimit dhe zëvendësministrat;
- zyrtarët e MASHTI;
- përfaqësuesit e Ministrisë së Financave;
- përfaqësuesit e LUX-DEV;
- përfaqësuesit nga diasporës;
- përfaqësuesit e KRU “Prishtina”;
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

4.1.1. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

- Gjatë muajit mars 2020, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit mars janë pranuar gjithsej 275 lëndë, prej tyre të miratuara janë 5, të refuzuara 2 lëndë, të pezulluara 3 lëndë dhe në proces janë edhe 265 lëndë për paga jubilarë.

6. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me Këshilla drejtues të shkollave;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësuesit e nxënësve të gjimnazit “Ahmet Gashit”.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i kurrikulës së re;
- Përhapja e pandemisë COVID-19.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.:

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;

- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA - shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Hartohet Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ;
- Zbatohet Plani për zhvillimin profesional;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garave të diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësohet gjendja e përgjithshme e infrastrukturës;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Hartohen listat për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;

- Krijimi i mekanizmave monitorues për përdorimin e kabineteve;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspektionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës, etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës - ne te të përfshihen edhe profesionistë - ekspertë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2019-2020 dhe konsultime me MASHT;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;

- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Furnizimi me inventar i disa shkollave;
- Furnizimi me rekuizita sportive i shkollave;
- Furnizimi me pajisje teknologjike i shkollave.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.